




REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E VUSHTRRISË

01 Nr. / Br. 224/17

Nr. i fq. / Br. sh. -5-

Data / Datimi 27. 07. 2017

VUSHTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -IV-TË E JASHTËZAKONSHME E -VIII-TË ME RADHË E**  
**KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 4 MAJ 2017**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 16:18.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:  
Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Bajram Mulaku, Kryetar i komunës, Dibran Përçuku nënkryetar i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesit e mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – konstatoi se në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e kuvendit dhe shtoi se materiali për mbledhje është dërguar me kohë, dhe kjo mbledhje është në përputhje të plotë me ligjin dhe Rregulloren e punës së kuvendit.

Në vazhdim kuvendi pas deklarimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë 2016-2024.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se Plani zhvillimor komunal si dokument strategjik është tejet i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të komunës. Andaj edhe njëherë përsëriti, duke bërë apel tek të gjithë udhëheqësit e partive politike të përfaqësuara në kuvend që të gjejnë një konsensus për aprovimin e këtij plani. Duke parë rëndësinë e këtij dokumenti për komunën tonë, iu sugjeroi grupeve kuvendare që të marrin një pauzë prej pesë minutave dhe të gjejnë një zgjidhje për aprovimin me konsensus të këtij plani.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – i ftoi të gjithë përfaqësuesit e partive politike dhe shefat e grupeve kuvendare, që të mbajnë një takim me kryetarin e komunës me qëllim që të gjendet një zgjidhje lidhur me aprovimin e këtij plani, në këtë rast kuvendi e ndërpreu

mbledhjen në një pauzë prej dhjetë minutave me qëllim të konsultimit mes grupeve kuvendare dhe kryetarit të komunës.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - pasi falënderoi përfaqësuesit e partive politike kuvendare për respektin që treguan për atë si kryetar i komunës, dhe në këtë rast njoftoi se ekziston një konsensus i përgjithshëm sa i përket stacionit të autobusëve pasi që prona e kësaj ish-ndërmarrjeje ndodhet në kontest gjyqësor. Ky konsensus konsiston që pjesa e pronave në zonën ku ndodhet stacioni i autobusëve të pezullohet nga trajtimi me anë të PZHK-së, dhe e njëjta me hartën zonale të parashihet një vend tjetër më i përshtatshëm ku do të vendosej stacioni i autobusëve. Ndërsa sa i përket zonës së tetë, se a do të jetë zonë ndërtimore apo zonë gjelbëruese, nuk është arritur ndonjë konsensus.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – kërkoi një pauzë shtesë prej pesë minutave me grupin e tij kuvendar për t'u konsultuar, në këtë rast përsëriti se qëllimi i tij nga fillimi ka qenë që PZHK-ja si dokument strategjik komunal të aprovohet me konsensus të plotë politik. Më tutje vlerësoi se pasi që konsensusi nuk u arrit, atëherë secili anëtar i kuvendit mund dhe është i lirë që të votojë sipas bindjes së lirë.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – ftoi shefat e grupeve kuvendare që të deklarohen për qëndrimet e tyre lidhur me votimin e PZHK-së.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – njoftoi se propozimi i grupit kuvendar të PDK-së është që të hiqet shenja e stacionit të autobusëve, për faktin që komuna mos të ketë barrë mbi veti në të ardhmen apo obligime nga ky kontest, dhe njoftoi se nëse kjo bëhet atëherë si grup do të marrin pjesë në votim.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se pas konsultave që bënë më herët nuk u morën vesh që të hiqet shenja e stacionit të autobusëve nga PZHK-ja dhe shtoi se ata ranë dakord që drafti i këtij plani të mbetet ashtu si është propozuar nga qeveria komunale, me kusht që të futen propozimet e bëra nga ana e tyre. Tutje vlerësoi se nuk është në kompetencën e kuvendit që të heq shenjën e autobusëve, për faktin se kjo çështje i përket mistrisë gjegjëse dhe se e njëjta është një çështje mjaft delikate dhe ligjërish e ndejshme. Ndërsa sa i përket zonës së tetë mendimi i përbashkët ishte që ajo të jetë zonë ndërtimore dhe këtu nuk kishte kundërshtime. Lidhur me kontestin për stacionin e autobusëve ekziston pajtueshmëria që në ndonjërin nga mbledhjet e kuvendit të vjen propozimi dhe të gjithë do të votojnë këtë propozim me qëllim që mos të dëmtohet komuna. Në fund tha se ata janë që drafti- i PZHK-së të aprovohet ashtu si është propozuar nga qeveria komunale konform pëlqimit të Ministrisë së Mjedisit, që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore, kurse për pronën e stacionit të autobusëve do të mund të votohej në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit pasi ajo pronë të hiqej nga kontesti ose të bëhej ndonjë zgjidhje tjetër e përshtatshme që mos të dëmtohet komuna dhe për këtë premtoi që grupi kuvendar i LDK-së do të votonte "për".

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se nëse i kishte keqkuptuar anëtarët e kuvendit atëherë kërkon falje, dhe shtoi se ideja ishte që stacioni i autobusëve të mos trajtohet me PZHK, dhe shenja të hiqet nga aty, apo në të kundërtën kjo çështje do të mund të votohej në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të kuvendit. Lidhur me këtë ai vlerësoi se nuk mund të lëshohet në interpretime ligjore, porse logjikisht del në sipërfaqe fakti se kuvendi si organ ka të drejtë që të vendos që një pjesë të pronave komunale në rastin tonë pronat e stacionit të autobusëve të mos trajtohen me PZHK, dhe të njëjtat më vonë të trajtohen në saxe të një dokumenti tjetër (me hartën zonale).

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se nga konsultat që kishin më herët u morën vesh që në të ardhmen nëse është ligjore të hiqej shenja e stacionit të autobusëve, por në këtë moment një propozim i tillë nuk mund të aprovohet për faktin se nuk e dimë akoma bazën ligjore, dhe me këtë m'u për shkak të kësaj çështjeje do të rrezikohej anulimi i komplet planit. Lidhur me këtë ai vlerësoi se në një mbledhje të ardhshme pas vlerësimit të bazës ligjore, çështja e stacionit të autobusëve do mund ndryshohej. Mirëpo si opozitë sot presin që ky plan të votohet

ashtu siç e ka propozuar qeveria komunale dhe konform pëlqimit të dhënë nga ministria gjegjëse.

**Adnan Klinaku, anëtar i kuvendit** – tha se Partia e Drejtësisë, nuk ka ndonjë qëndrim të qartë lidhur me PZHK-në, për shkak të mos konsensusit të grupeve parlamentare në përgjithësi. Andaj njoftoi se ai personalisht lidhur me këtë çështje do të abstenojë.

**Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit** – tha se është “për” që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore, dhe që sot të votohet edhe për stacionin e autobusëve me qëllim që t’i shmangemi rrezikut të dëmtimit të buxhetit të komunës.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – tha se e përkrah kërkesën e 1/3 e anëtarëve të kuvendit për thirrjen e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, dhe e përkrah Draft-planin zhvillimor komunal, ashtu siç e ka propozuar qeveria komunale pa ndryshime.

**Shaban Beka, anëtar i kuvendit** – tha se nëse dëshirojmë të bëjmë ndryshime në këtë dokument, atëherë ka hapësirë që edhe në pjesë tjera të bëhen ndryshime. Pastaj ceku se për këtë plan është diskutuar bukur gjatë dhe nuk është arritur marrëveshje, andaj lidhur me këtë propozoi që të shkohet nga fillimi ndryshimi i këtij dokumenti ose të votohet sot sipas pëlqimit të dhënë nga ministria gjegjëse.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** – tha se mbetet në qëndrimin e mëhershëm që zona e tetë të jetë zonë ndërtimore dhe ceku se ky plan duhet të votohet sot.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se sa i përket heqjes së shenjës së autobusëve si dhe ndryshimit të PZHK-së atëherë duhet ditur që ndryshimi i këtij plani bëhet sipas procedurave për aprovimin e Planit zhvillimor komunal, dhe se këto ndryshime nuk mund të bëhen me vendime ashtu siç po deklarohet këtu. Lidhur me çështjen e stacionit të autobusëve kemi opinion e Zyrës ligjore, si dhe një kërkesë nga ana e pronarëve të asaj prone. Prandaj si përfundim i krejt kësaj, si dhe pas situatës ku nuk u arrit konsensusi lidhur me aprovimin e këtij plani, dhe për heqjen e shenjës së stacionit të autobusëve, atëherë grupi kuvendar i PDK-së, nuk do të merr pjesë në votim, për faktin se si grup nuk janë dakord sikur disa individë të caktuar që të dëmtohet buxheti i komunës, sepse dihen se cilat janë vendimet e gjykatës, dhe në këtë rast nga disa individë ka tendenca që të dëmtohet buxheti i komunës. Në këtë rast si grup kuvendar njoftoi se në mënyrë demonstrative do ta lëshojnë këtë mbledhje, dhe në këtë formë nuk do të marrin përgjegjësi nëse buxheti i komunës dëmtohet sa i përket kësaj. Gjithashtu njoftoi se nuk dëshiron të jetë pjesë apo nënshkruar i një vendimi me të cilin dëmtohet buxheti i komunës, dhe vlerësoi se këtë vendim le ta nënshkruajnë ata të cilët e “njohin më mirë ligjin dhe i dinë më mirë rrethanat ligjore” dhe kështu ata e lëshuan mbledhjen duke cekur një thënie të anëtarit të kuvendit Qerim Selimi: “rruga e mbarë pa ne”.

*Pas diskutimit të kryesuesit të kuvendit z. Shpëtim Zhegrova, grupi kuvendar i PDK-së, dhe anëtar i kuvendit nga radhët e komunitetit serb lëshuan mbledhjen e kuvendit, në sallë mbetën 22 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për të vazhduar punimet e mbledhjes.*

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – tha se sot kishte ardhur në mbledhje për të votuar ashtu siç ishte deklaruar në mbledhjen e fundit grupi kuvendar i PDK-së, por megjithëkëtë tashmë janë mësuar që ata mos të jenë korrekt me anëtarët e kuvendit dhe me qytetarët e komunës sonë. Tutje duke pasur referencë ligjin i cili e rregullon çështjen e zëvendësimit të kryesuesit të kuvendit, ftoi anëtarin më të vjetër të kuvendit që të kryesojë mbledhjen z. Muharrem Shabani.

**Në vazhdim mbledhjen e udhëhoqi Muharrem Shabani, anëtari më i vjetër i kuvendit.**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – pasi përshëndeti të pranishmit, sqaroi se janë të plotësuar të gjitha kushtet ligjore për vazhdimin e kësaj mbledhjeje të kuvendit.

*Pas deklarimit të anëtarëve të kuvendit, kuvendi me 22 vota "për" aprovoi propozimin që mbledhjen ta kryesojë dhe udhëheq anëtari më i vjetër i kuvendit z. Muharrem Shabani, si dhe me vota unanime u rikonfirmua, aprovimi i rendit të ditës.*

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se asnjëherë nuk kishte menduar që pas gjithë këtyre zhvillimeve, ne si zyrtarë të komunës të mos mund të merremi vesh për aprovimin e një plani që është kaq jetik për interesat e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Pastaj ai shtoi se ndihet i nderuar dhe krenar për votat që i kanë dhënë qytetarët e komunës, dhe ceku se gjithmonë me besnikëri dhe me nder do t'iu shërbejë vetëm interesave të përgjithshme të qytetarëve tanë. Në fund deklaroi se Plani zhvillimor komunal si një "kushtetutë" për qytetin tonë është shumë me rëndësi që sot të aprovohet dhe ceku se ai do ta mbështet me votë "për" këtë dokument.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – duke iu referuar kryesuesit të kuvendit, për çështjen e lëshimit të mbledhjes nga ana e tij, ceku se anëtari më i vjetër ka të drejtë të udhëheq mbledhjen dhe propozimi i saj për drejtimin e mbledhjes është në harmoni me ligjin. Tutje lidhur me PZHK-në shtoi dhe apeloj që ai të aprovohet ashtu si e ka propozuar qeveria komunale. Lidhur me zonën e tetë përsëriti se në mbledhjen e muajit dhjetor të vitit të kaluar, grupi kuvendar i PDK-së ishte deklaruar se janë që ajo zonë të mbetet gjelbërim, kurse në njërin nga mbledhjet e kaluara ata sikur e ndërjuan qëndrimin dhe deklaruan që janë "për" që ajo zonë të jetë ndërtimore, andaj vlerësoi që nuk është në rregull që diçka tjetër të thuhet e krejt diçka tjetër të veprohet. Në fund tha se do ta votojë "për" këtë plan ashtu si është propozuar nga qeveria komunale.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – tha se është për keqardhje mënyra se si po funksionon kuvendi në këto rrethana, dhe shtoi se ka qenë dhe është që ky plan të aprovohet ashtu siç e ka propozuar qeveria komunale. Në fund i falënderoi anëtarët e kuvendit që nënshkruan kërkesën për thirrjen e mbledhjes dhe ata që qëndruan në sallën e kuvendit.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** – tha se Drejtoria e Urbanizimit ka bërë një punë shumë të madhe në hartimin e PZHK-së, dhe shtoi se dëshira e tij ishte që ky dokument të aprovohet me konsensus politik. Pastaj vlerësoi se ky plan është një dokument multidimensional dhe për jetësimin e tij duhet të përfshihen të gjitha segmentet e jetës komunale. Mandej kërkoi që nga plani të hiqet fjalia që hamami i qytetit ka qenë: "kishë katolike dhe banjë romake".

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se e keqja më e madhe që ka mundur të ndodh me këtë plan është që e tërë vëmendja është përqendruar në një zonë ndërtimi, zona e tetë dhe shprehu shpresën e tij se në të ardhmen do të ndryshohet ky dokument në pjesë të caktuara me qëllim të përmirësimit. Në këtë rast ai njoftoi se për shkak të shtyrjeve që kanë ndodhur dhe për shkak të nevojës që ka qyteti ka vendosur që të përkrah këtë plan.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – tha se grupi kuvendar i LDK-së, ka kërkuar qysh para disa muajve që të aprovohet Plani zhvillimor komunal, si një dokument shumë i rëndësishëm dhe strategjik i komunës dhe madje me kohë kanë kërkuar që ky plan të aprovohet me konsensus politik të të gjitha partive politike. Pastaj përsëriti se janë që zona e tetë të jetë zonë në tërësi ndërtimore me qëllim që të krijohen mundësi të barabarta për të gjithë pronarët e pronave që gjenden në atë zonë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – në rekapitullimin e debatit lidhur me pikën e rendit të ditës, vlerësoi se sa i përket aprovimit të PZHK-së është shterur debati, dhe tani janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që ky dokument të aprovohet. Në kontekst të kësaj ky dokument ka kaluar nëpër të gjitha etapat ligjore, duke marrë pëlqimin nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mandej lidhur me zonën e tetë bëri të ditur se kjo zonë ka qenë e trajtuar si zonë ndërtimore në këtë draft-plan dhe në këtë formë e ka marrë pëlqimin nga ministria gjegjëse, mirëpo më vonë kjo zonë është ndryshuar nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe ceku se nuk është mirë që të biem pre e këtyre lojërave jo të ndershme. Andaj në fund tha se ka ardhur koha që ky dokument të aprovohet në ç' rast konstatoi se në sallë janë të pranishëm 22 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimit të plotfuqishëm. Pas të gjitha këtyre ai hodhi në votim Planin zhvillimor komunal sipas


propozimit të qeverisë komunale dhe konform pëlqimit të marrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe kërkoi që pjesë e këtij vendimi të jetë edhe një pikë me të cilën shfuqizohet vendimi i mëparshëm lidhur me aprovimin e PZHK-së.

*Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas deklarimit me 21 vota “për”, 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:*

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmer masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë këtë çështje.
3. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që ta zbatojë dhe që të regjistrojë në RDPP të dhënat e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Plani Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, shfuqizohen Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban i Vushtrrisë 2009-2014<sup>+</sup>, Plani Rregullues Urban Zona 1-“QENDRA”, Plani Rregullues Urban Zona 2-“URA E GURIT”, Plani Rregullues Urban 3-“LUMI TËRSTENA”.
5. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 01.Nr-62/17 i datës 10.03.2017, lidhur me aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:36.*

**Bastri Duraku**



Procesmbajtës

**Muharrem Shabani**



Anëtar i Kuvendit

